



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më
28.2.2013, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Prof.dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mejdiu, Sadri Ramabaja dhe Engin Beyoglu.

Munguan: Afërdita Veliu dhe Avdush Dobratiqi.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të INPO-së, dhe të mjeteve të informimit. Mbledhjen e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Valon Hiseni bëri një njoftim për anëtarët e Kuvendit, se nga sot kaloj nga AKR-ja në LDK, dhe ky vendim i imi është në përputhje të plotë me bindjet e mia, i përkrahur nga familja, miqtë dhe shokët e mi.

Shemsi Veseli, në emër grupit parlamentar të PDK-së, kërkoi që në njërin nga mbledhjet e radhës të Kuvendit, të futet në rend dite kërkesa për gjetjen e një lokacioni të mundshëm për ndërtimin e objektit të Fakultetit të Mjekësisë.

Sadri Ramabaja ngriti shqetësime rreth çështjeve që kanë të bëjnë me mosrespektimin e Statutit të Komunës dhe Rregullores së Kuvendit . Së pari sa i përket dërgimit të materialit, pasi që ne materialet i kemi marrë tri ditë para se të filloj mbledhja, pra jo në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Komunës.

Shqetësimi i dytë ka të bëjë me çështjen e komiteteve, në fakt e rendit të ditës, neni 5 pika 2 e rregullon edhe këtë çështje, konkretisht pika 2 c. Këto çështje ne po i ngremë në fund të rendit të ditës, kur praktikisht humbë disponimi i pjesës dërmuese për të dëgjuar. Ai bëri thirrje që në mbledhjet e ardhshme, të respektohet neni 5 pika 5. 2 c.

Me shumicë votash, një abstenim (Sadri Ramabaja), u miratua ky

R E N D D I T E :

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e parë;**
- 2. Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale;**
- 3. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit "Prek Jakova" në Prishtinë;**
- 4. Propozimi për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim;**
- 5. Propozimvendimi për rritjen e të hyrave vetjake për bartjen e mjeteve nga viti 2012 në vitin 2013;**
- 6. Propozimvendimi për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim;**
- 7. Propozimvendimi për bibliotekën komunale "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë;**
- 8. Propozimvendimi për teatrin e qytetit "Dodona" në Prishtinë;**
- 9. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" SHA në Prishtinë;**
- 10. Pyetje dhe përgjigje;**
- 11. Të ndryshme.**

Pika e parë

Kimete Zeqa bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit, konkretisht për diskutimin e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, rreth suksesit të nxënësve, si dhe mungesën e kapacitetit për monitorimin e procesit arsimor.

Mendoj se duhet të kontaktojë, ose të bisedoj me arsimtarë, ose mësimdhënës nëpër shkolla, sepse kam informata që edhe sukcesi ndikon në këtë drejtim. Kam të dhëna se arsimtarët kërkojnë nga nxënësit të paguajnë nga 50 € në muaj, pra kërkoj që kjo vërejtje të merret parasysh, sepse duhet kontrolluar

shkollat se në çfarë mënyre punojnë mësimdhënësit, prandaj edhe suksesi i nxënësve është në këtë gjendje si është.

Lidhur me Propozimvendimin për plotësimin e Statutit të QKMF-së, që 21 qershori të jetë Dita e Shëndetësisë në komunën e Prishtinës, pajtohëm dhe ju përgëzoj për këtë. Gjithashtu, e përkrahu edhe diskutimin e z. Makolli për pikat që kanë të bëjnë me shëndetësinë, por paraprakisht do të ishte mirë që ato të shqyrtoheshin në Komitetin për shëndetësi.

Naim Makoll bëri vërejtje në pikën e tretë të ekstraktit të procesverbalit, lidhur me diskutimin për Hortikulturën, duke cekur se nuk është shkruar çështja të cilën e kam ngritur e që ishte diskutimi rreth çmimit 230 € të atyre fidanëve.

Feti Mehdiu tha se në diskutimin tim mungon diçka që e ka lënë të paqartë atë që e kam thënë. Kam thënë që mjafton të mendohet për 200 apo 300 vjet për ata fidanë, e jo për 500 vjet.

Me vërejtje dhe plotësime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin e rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, të pranishmit, në pika të shkurtra, i informoi Agim Dibrani, drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, e përkrahu këtë propozimvendim, duke konsideruar se do të ndikojë në stimulimin e veprimtarive biznesore.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, e përkrahu këtë propozimvendim për miratim, duke përshëndetur edhe heqjen e tarifave për disa veprimtari, të cilat përballen me kushte të rënda të veprimit. Njëherësh kërkoi që disa zeje, të cilat janë në shuarje e sipër, të kenë një lloj stimulimi nga Komuna, që së paku të kenë mundësi mbijetese.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se është për t'u përshëndetur ky propozimvendim. Ky është një udhërrëfyes i mirë edhe për komunat tjera, që të mendojnë për stimulimin e bizneseve. Kërkoj një sqarim rreth tarifave vjetore, që kanë të bëjnë me mjetet që kanë të bëjnë me shëndetësinë, për të cilat vërehet se është një dallim i madh. Gjithashtu nuk do të ishte mirë që të bëhet krahasimi i një tarife të lojërave të fatit dhe bastoreve, me një tarifë të njëjtë kur kemi të bëjmë me mjete që nevojiten për shëndetin e njeriut. Po ta krahasojmë tarifën prej 500 € për mjetet medicinale me ato të automatëve të lojërave të fatit 300 €, është një diskrepancë që nuk mundet të akceptohet mirë, dhe është mirë që në të ardhmen të merren parasysh këto, në mënyrë që këto tarifa të kenë njëfarë ndryshimi dhe dallimi sa i përket tatimit.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna janë marrë parasysh dhe e përkrahu këtë propozimvendim, me konstatimin që ky vendim është pozitiv dhe korrespondon edhe me kërkesat e

parashtruara nga bizneset e komunës së Prishtinës, e në veçanti zejtarët, dhe është një përmbushje e obligimeve tona ndaj tyre, sepse ata janë taksapagues të rregullt dhe si të veçantë. Në këtë drejtim edhe jemi që në kuadër të kërkesës, përmes subvencioneve të ndryshme, të ndihmohen në veçanti ato biznese - veprimtari, të cilat në njëfarë mënyre janë në shuarje e sipër.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi. Ai shprehu mendimin se duhet të bëhet një diskutim pak më i gjerë për profesionet, zanatet, zejtaritë të cilat janë në zhdukje e sipër. Kemi nevojë për një vend, një qendër dhe drejtpërdrejt të subvencionohen ato, ndoshta edhe në formë të të ardhurave personale për ata njerëz që i punojnë ato. Është mirë që Komuna të ndajë mjete për këto veprimtari, të cilat mund ta ruajnë një kulturë të punës që e kemi pasur dikur.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se pajtohem me këtë propozimvendim, duke e përgëzuar drejtorinë përkatëse që ka bërë punë të rëndësishme. Megjithatë, shprehu mospajtime në disa kategori, si p.sh. në rastet kur bëhet përmirësimi i të dhënave ose korrigjimi i emrit, qytetari nuk duhet të paguaj fare.

Sa i përket bastoreve, ato ndikojnë negativisht në suksesin e nxënësve nëpër shkolla, andaj për këtë do të ishte mirë që bastoret të mos jenë afër shkollave, dhe kjo do të duhej të merrej parasysht.

Ngarkesat vjetore për veprimtaritë botuese, te gazetat, tarifa prej 400 € është e lartë, besojmë se do të duhej të ishte 300 €, gjithashtu kjo shumë të jetë edhe te veprimtaritë e shtypshkronjave. Është e paarsyeshme që një argjendari të tathohet më pak sesa një tregtar i rëndomtë i librave.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se ky propozimvendim është në funksion të fushatës elektorale, përpjekjes për të blerë vota. Ku ishit që 3 vjet?! Pse nuk e ndërmoret këtë masë më herët?!

Ne si VV, propozojmë që bizneset e rralla, të cilat janë në zhdukje e sipër, por që qytetarët kanë nevojë për shërbime të kësaj natyre, t'iu hiqet krejtësisht kjo taksë. Siç e dini, për bizneset tjera kemi pikëpamjet që ndërlidhen me politikat sociale, mirëqenien e qytetarëve, e që nënkupton zbatimin e taksës progresive, që nuk vërehet këtu, kur dihet se argjendari tathohet shumë më pak sesa një tregtar i rëndomtë i librave. Këto janë arsye të mjaftueshme, e para ekskluzivisht politike, e dyta parimore, për të cilat ne nuk do të votojmë për këtë vendim, pra jemi kundër.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, **Agim Dibrani** dha sqarime të nevojshme.

Me shumicë votash, një abstenim (Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe të baletit “Prenk Jakova” në Prishtinë, të pranishmit i njoftoi Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, shprehu mendimin se lokacioni më i përshtatshëm ka qenë ai i propozuar në Tauk-bahçe, por doli se është pronë private. Objekti ekzistues, në të cilin ende vijohet mësimi, është në gjendje mjaftë të keqe. Kisha kërkuar që në gjysmëvjetorin e dytë, ose nga pushimi i marsit, ata nxënës të largohen prej atij objekti, pasi që paraqet rrezik për ta. Sa i përket transferimit të nxënësve në objektin e Shkollës Ekonomike, kërkoj që të analizohet edhe një herë kjo çështje dhe të gjendet diku një shkollë më afër.

Vjollca Rizani, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar këtë vendim, dhe të gjithë njëzëri jemi pajtuar dhe e përkrahim për miratim.

Sadri Ramabaja tha se vendimi që ishte marrë herën e kaluar, kishte të bënte me parcelën me sipërfaqe prej 4.400 m², ndërsa parcela që i ofrohet tash shkollës ka një sipërfaqe shumë më të vogël. Kjo hapësirë nuk besoj se i përmbushë nevojat e kësaj shkolle. Është dashur që Komuna të insistojë në ekzekutimin e vendimit paraprak, sepse duke vepruar kështu, po stimulon uzurpuesit e hapësirës dhe pronës publike.

Mejreme Berisha, tha se e përkrahim këtë propozimvendim, por të vetmen vërejtje e kemi për hapësirën, e cila është e vogël krahas nevojave që ka kjo shkollë.

Vjollca Dibra-Ibrahimi tha se lokacioni i propozuar për vijimin e mësimin për nxënësit e Shkollës së Muzikës nuk është edhe aq larg. Si objekt i ri dhe me hapësirë parkingu, besoj se tani për tani i plotëson shumë më mirë kriteret se aty ku është Shkolla e Muzikës.

Komuna ka herë ka filluar të merret me çështjen e objektit të Shkollës së Muzikës, dhe përpjekjet tona kanë qenë të vazhdueshme për ta gjetur një hapësirë të përshtatshme, por, për shkak të pengesave në aspektin ligjor, është detyruar që shkollën ta ndërtojë në parcelën ekzistuese.

Shefki Gashi, lidhur me lokacionin, tha se Prishtina është ngushtuar, dhe vazhdon të ngushtohet gjithnjë e më shumë, por mjetet duhet të shpenzohen, të ndërtohet shkolla, të krijohen kushtet e brendshme, e sa për aktivitetet tjera, ka edhe salla të tjera.

Prof.dr.Isa Mustafa, Kryetari i Komunës, tha se ky është lokacioni i katërt që ne po e caktojmë për Shkollën e Muzikës. Ka qenë një lokacion këndej Lakërishtës, pastaj në Velani, ku ka qenë Poligoni i shenjëtarisë, pastaj ka qenë ky lokacioni paraprak, dhe Kuvendi ka vendosur, në fillim të vitit të kaluar, për lokacionin në lagjen “Kodra e Diellit”. Për këto lokacione dolën pengesa ligjore dhe

pengesa të tjera, që kanë bërë të pamundur ndërtimin e shkollës. Lidhur me vendosjen e nxënësve, ka qenë një propozim që ata të vendosen në Shkollën e Mesme në Fushën e Pajtimit, që është më afër, por nga shkolla është kërkuar që të vendosen nxënësit përkohësisht në ish-objektin e Shkollës Ekonomike, pra në objektin e vjetër të kësaj shkolle, jo në objektin e ri, sepse aty ka më shumë klasë, më shumë hapësirë.

Me shumicë votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit "Prenk Jakova" në Prishtinë.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, në pika të shkurtër informoi Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.

Nexhmije Berisha, në emër të GP të LDK-së, tha se duke e pasur parasysh Ligjin në fuqi për dhënien në shfrytëzim, dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ku dispozitat e këtij ligji Komunës i japin të drejtën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, në këtë propozim janë paraqitur qartë arsyet që janë për interesin publik. Ndër të tjera, është dhënë edhe specifikimi që përmban emërtimin e pronësisë, sipërfaqen e saj, arsyetimin, qëllimin dhe kohëzgjatjen, prandaj si GP e miratojmë këtë propozimvendim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, bëri vërejtje në materialet e fotokopjuara, duke thënë se ato nuk mund të lexohen, dhe kërkoi që në të ardhmen të merret parasysh kjo vërejtje, në mënyrë që materiali të jetë më i kompletuar. Do të ishte mirë që të dihet se në këto parcela a ka ndonjë uzurpues dhe, nëse ka, ta dimë se ku dhe kush janë ata. Si GP këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimvendim, por realisht nuk kemi vërejtur këtu se cili është interesi publik i Komunës që është dhënë ajo parcelë. Pra, çështja e transparencës është shumë e dobishme për këto raste, dhe të dihet cilët janë personat uzurpues, të dihen me emër dhe mbiemër. Është koha e fundit që t'iu tregohet atyre individëve të cilët bëjnë shkelje ligjore, pavarësisht kush janë ata, pra, se ku e kanë vendin dhe jo me e shfrytëzuar tash pronën, se menjëherë po krijohet terren i përshtatshëm.

Pse po tolerohet, pse nuk po merren masa konkrete, pse nuk po largohen dhe cilët janë ata uzurpator?!

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, ne do të jemi të rezervuar për miratim.

Shefqet Sylejmani, ne emër të GP të AAK-së, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi. Ai shprehu mendimin se ky vendim është duke u bërë për eliminimin e të gjitha këtyre dobësive, Ne këtu e shohim zgjidhjen, pa ndonjë paragjykim, dhe jemi për këtë, pra kjo është në funksion të atyre kërkesave që u thanë me të drejtë nga kolegët.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se në atë pjesë ne realitet njerëzit kanë vendime prej qeverive të ndryshme, sepse atje ka qenë për një kohë kufiri i Komunës, kinse i padefinuar, edhe pse në pikëpamje të kadastrave ka qenë i definuar, dhe kanë ndërtuar me leje e pa leje, ku ka edhe uzurpime prej të gjitha llojeve. Mendoj që të shkohet me ankand publik, por gjithnjë duke pasur parasysh që mos të hapim konflikte në mes të firmave të ndryshme atje dhe njerëzve, sepse është një përgjegjësi edhe e jona që t'i punojmë gjërat me mençuri dhe më ngadalë.

Feti Mehdiunë, emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se qëndrojmë pas të gjitha këtyre sugjerimeve, duke i shtuar edhe këtë: Afati për dhjetë vjet mendojmë se hapë më shumë mundësi për keqpërdorime. Prandaj, le të jetë për dhjetë vjet, por me një përkufizim, që në krye të pesë viteve të jepet një llogari, kush si e shfrytëzon atë pasuri. Mendoj se kështu do të jemi më shpejtë në shërbim të korrigjimit të disa gjërave.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se as për këtë vendim nuk kemi shpjegime të detajuara. Çfarë leverdie kanë qytetarët e komunës nëse iu jepen këto parcela kësaj kategorie biznesmenësh? Nga përvoja e jonë në të kaluarën, kemi fituar përshtypjen se më shumë kemi të bëjmë me politikë klienteliste, sesa me nxitje të biznesit. Në fakt, duke e parë se kush është prapa këtyre, kush i ka shfrytëzuar deri më sot këto parcela, shihet se politikat klienteliste janë shumë prezente. Nëse ka persona, ndaj të cilëve Komuna paska iniciuar procedura gjyqësore, siç potencoi kryesuesi këtu, atëherë është shumë e qartë se ata do të duheshin të eliminoheshin qysh në fillim, të mos të lejohen që të konkurrojnë. Meqë ka shumë të panjohura në këtë sferë, në emër të VV-së, kërkoj që të na vihen në dispozicion dokumentacionet e ankandit publik, në afatin e duhur.

Tefik Mehmet tha se këto parcela jepen në shfrytëzim të përkohshëm, nga individ apo kompani, të cilat ofrojnë kushte më të mira, pra Komuna dëshiron që ta marrë në menaxhim pronën e vetë dhe të fitojë prej saj. Leverdia është kjo, dhe unë jam i bindur se ekzekutivi e ka analizuar mirë se cilat parcela mundet dhe duhet t'i japë në shfrytëzim.

Naim Makolli tha se disa taksa për metër katrorë për sipërfaqe që jepen në shfrytëzim, të cilat i kemi miratuar më herët, a do të bie në kundërshtim kjo tani nëse ne e qesim në tenderim atë. Mendoj se këtu ka njëfarë lloj averzioni ndaj bizneseve që zhvillojnë veprimtari në komunën e Prishtinës. Tokën që ka mundësi Komuna e Prishtinës ta japë në shfrytëzim për qytetarë dhe biznese të ndryshme dhe me tarifa sa më të ulëta, duhet ta përkrahim, sepse e ndihmohet biznesi.

Me shumicë votash, pesë kundër, u miratua Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimvendimin për rritjen e të hyrave vetjake për bartjen e mjeteve nga viti 2012 në vitin 2013, të pranishmit i informoi Xhelil Bekteshi, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Tefik Mehmeti, në emër të GP të LDK-së, tha se këtë pike të rendit të ditës thujse se për çdo vit e kemi shtjelluar dhe e kemi pas si pikë. Në nenin e parë të këtij vendimi është një shumë mbi 1 milion euro, që është tejkalim i të hyrave vetanake, që është një rezultat jashtëzakonisht i mirë i Komunës së Prishtinës që ka arritur ti tejkalojë të hyrat vetanake të planifikuara, ndërsa në vazhdim është bartja e mjeteve nga projektet që janë në vazhdimësi për vitin 2013. Edhe këto janë të kategorizuara sipas kategorive paga dhe mëditje, mallra, subvencione dhe investime kapitale, çka është edhe kjo shumë e mirë, sepse shumica e mjeteve janë në investime kapitale, çka duhet përkrahur.

E vërteta është se problemet pronësore janë faktorë që po ndikojnë në mos përmbushjen e planifikimeve për realizimin e buxhetit dhe përfundimin e projekteve në kohë të planifikuara. Sa i përket destinimit të mjeteve, ato janë paraqitur në forma tabelore, janë shumë mirë të specifikuara, dhe besoj se të gjithë pajtohem me këtë shpërndarje nëpër kode të caktuara.

Një element kisha duhet cekur, se në institucionet ku ka menaxherë të mirë dhe profesional, bartja e mjeteve është më evidente për shkak të kontrolleve të vazhdueshme dhe moslejimit të pagesave pa përfundimin me sukses të projektit. Si GP, pajtohem me këtë bartje dhe shpërndarje nëpër kode të caktuara.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se sa i përket arsytimit të këtij vendimi, që kryesisht është koncentruar rreth bartjes së mjeteve, është plotësisht i kuptueshëm. Prandaj, për bartjen e mjeteve prej vitit 2012 në vitin 2013, nuk kemi se çka të mos e pranojmë, në fakt edhe si Grup parlamentar kemi marrë vendim që këto mjete, së paku në gjashtëmujorin e parë, të harxhohen në projektet që janë në arsyetimin e tillë.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se gjithmonë e kemi përkrahur bartjen e mjeteve për projektet e mëdha edhe ridentimin e mjeteve, por nuk mund të themi se ka planifikim të mirëfilltë. Është mirë që të dihet se ku po harxhohet dhe investohet me paratë publike, dhe këtë duhet ta parashih drejtori me ekipin e tij, prandaj nuk mund të themi tash se ka planifikim të mirë në bazë të dinamikës së realizimit të projekteve.

Gjithsesi duhet të bëhet edhe përcaktimi i dinamikës, ku në bazë të dinamikës edhe të zotohen mjetet, e jo tash ta bëjmë zotimin më tepër sesa duhet.

Si GP do ta përkrahim, për arsye se këto mjete shkojnë në investimet kapitale, pjesa më e madhe, dhe në marrëveshje me Ministrinë e Financave. **Shefqet Sylejmani**, në emër të GP të AAK-së, tha se për hir të objektivitetit dhe qasjes sonë konstruktive që e kemi karshi veprimit, konsiderojmë të përbashkët të këtij Kuvendi të Komunës së Prishtinës, pjesë e të cilit jemi, i kemi thënë objektivisht këto vështirësi që po paraqiten prej viti në vit, duke filluar prej problemeve në pronë, problemeve në ligjin e prokurimit dhe procedurat e prokurimit, e deri te problematika e gjithmbarshme e kryerësve të punimeve.

Është mirë që me këtë rast është dhënë ky shpjegim plotësues në dokumentin që e kemi, dhe konsiderojmë se është mirë që edhe planifikimi për shpenzimet, gjegjësisht për investimet në këtë drejtim janë të qëlluara. E përkrahim, në veçanti ndarjen e mjeteve për blerjen e autobusëve për NPK "Trafiku Urban", prandaj ne e përkrahim këtë dhe e përgëzojmë edhe drejtorinë përkatëse që ka tejkalim në mbledhjen e asaj që quhet një menaxhim i mirë i financave në Komunën e Prishtinës.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se edhe ne në parim e përkrahim këtë propozimvendim. Në këtë material janë thënë disa çështje, të cilat paraqesin pengesë në realizimin e projekteve, siç janë pengesat tek çështjet pronëso- juridike, te aftësia e punëkryesve etj.

E përkrahu ndihmën për NPK "Trafiku Urban" në shumën e mjeteve prej 2 milion euro, por kisha kërkuar që blerja e atyre autobusëve të menaxhohet pak më mirë. Gjithashtu kërkoi që një sasi e mjeteve të ndahen edhe për bujqësi, gjegjësisht për miniferma të vogla, ku do të ishte një menaxhim pozitiv i parasë publike, përndryshe është menaxhim pozitiv nëse këto mjete nuk dalin deficit dhe suficit.

Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, tha se këtë dokument do ta përkrahim ashtu si është, me një sugjerim të Sektorit të Kulturës.

Si po thuhet dhe si po shihet, punëkryesi për restaurimin e Hamamit të Madh të Prishtinës nuk po i kryen punët ashtu si duhet. Ai nuk po e përdor materialin që duhet, andaj do të ishte mirë që edhe Hamami, edhe Xhamia e Çarshisë ta kenë një mbikëqyrje më profesionale.

Ai sugjeroi që t'i jepet më shumë rëndësi furnizimit me libra në bibliotekën "Hivzi Sylejmani" sesa furnizimit me mobilie.

Sadri Ramabaja tha se Vetëvendosje kësaj pike i ka kushtuar rëndësinë më të madhe, se këtu, madje qysh edhe në titull, shihet përpjekje për të fshehur esencën e krejt vendimit. Nuk ka të bëjë shumë me rritjen e të hyrave vetanake, sa ka të bëjë ekskluzivisht me bartjen e mjeteve nga viti 2012 në vitin 2013. Ky vendim është ekskluzivisht manipulim i pastër elektoral, me paratë e buxhetit po planifikohet të blihet vota. Në vend se këto mjete të

shpenzoheshin dhe të hynin në qarkullim komplet, të rregullohej mirëqenia dhe jeta e qytetarëve, barten edhe në gjashtëmuorin e dytë të këtij viti, sepse dihet arsyeja pse. Kjo është njëra prej arsyeve shtesë, për të cilën ne paralajmërojmë se do të protestojmë ashpër.

Mejreme Berisha, sa i përket çështjes së NPK “Trafiku Urban”, tha se vërtet është momenti i fundit që të i ofrojmë diçka atyre dhe atij institucioni. Asnjë institucion nuk ka qenë i ndëshkuar si Trafiku Urban në kryeqytetin tonë. Vetëm ne qytetarët e rëndomtë që udhëtojmë me ta për çdo ditë, e dimë hallin e atyre njerëzve. Dëshiroj që stacioni i fundit i Trafikut Urban të jetë Matëçan, dhe atje t’ia caktojmë hapësirën.

Milazim Vitija tha se te kategoria e subvencioneve, është mirë që sa më tepër t’i përkrahim bujqit dhe blegtorët e komunës së Prishtinës, për shumë arsye, në mënyrë që ata tash ta rrisin prodhimtarinë e tyre bujqësore dhe blegtorale.

Komuna e Prishtinës vitin e kaluar e ka bërë një punë të mirë me vaksinimin e bagëtive dhe qenve, prandaj i propozoj këtij Kuvendi që nga këto mjete të ndahet përsëri një shumë e mjeteve dhe të jetë një pozicion i veçantë për vaksinimin e bagëtive në komunën e Prishtinës.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna rreth restaurimit të Hamamit të Prishtinës dhe furnizimit me libra të bibliotekës së qytetit, **Vlora Dumoshi**, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dha sqarime të nevojshme.

Për vërejtje dhe sugjerime të dhëna lidhur me këtë propozimvendim, **prof. dr. Isa Mustafa, Kryetar i Komunës**, tha se titulli i Vendimit është në bazë të asaj çfarë e kërkon Ministria dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse ne duhet të konstatojmë me një vendim, që ka pasur rritje të mjeteve dhe të na lejohet që atë rritje të mjeteve ta shfrytëzojmë. Prandaj, nuk është çështje e kamuflimit, por është çështje e obligimit ligjor. Është një shumë e mjeteve, e cila në pjesën dërmuese ka qenë e kontraktuar gjatë vitit të kaluar në projekte, të cilat i bartim si projekte në këtë vit.

Në realizimin e projekteve, kanë ndikuar shumë faktorë që nuk kanë përfunduar me kohë, andaj këto situata po na përcjellin prej vitit në vit.

Te NPK “Trafiku Urban”, ne jemi orientuar që të japim 2 milion për blerjen e autobusëve dhe jemi në një marrëveshje me “Xhajnën” me Agjencinë Japoneze për Zhvillim Ekonomik, që na kanë premtuar pesëdhjetë për Trafikun Urban.

Janë edhe disa kontrata që janë në bashkëpunim me Ministrinë për projekte në infrastrukturë. Mjetet e bartura për këtë vit do të shpenzohen në shumë projekte, të cilat duhet të realizohen brenda këtij viti.

Me shumicë votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për rritjen e të hyrave vetjake për bartjen e mjeteve nga viti 2012 në vitin 2013.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, Tefik Mehmeti, në emër të GP të LDK-së dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit vlerësues, tha se procedura për përzgjedhjen e ofertuesit më e mirë për dhënien në shfrytëzim të pronës publike të Komunës me qira për një kohë të caktuar, ka shkuar në mënyrë të drejtë dhe konform Ligjit publik të prokurimit të Kosovës.

Kanë aplikuar 4 kompani, që të gjitha i kanë plotësuar kushtet e kërkuara në tender të njëjtë. Si Komision, propozojmë që kontrata t'i besohet kompanisë AMM, e cila ka ofruar çmimin më të lartë në të dyja llotot, sepse kanë pasur mundësi të konkurrimit të ndryshëm në secilin loto.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se për këtë propozimvendim kërkuam edhe në KPF, që pasi kanë qenë katër konkurrent, të na jepen çmimet e të katërve, por tani po shihet se për dy konkurrentë janë sjellë çmimet, pra pavarësisht nga ajo, duke llogaritur se komisioni ka punuar dhe vepruar mirë.

Sadri Ramabaja tha se ne po luajmë me ndërgjegjen e qytetarëve, sepse edhe unë nuk jam kundër asaj që të jepen 200 milion, madje edhe 500 milion, dhe më gëzoi fakti që donatori madje kushtëzon që ndërmarrja të jetë publike, por çështja është e manipulimit, dhe me një të tretën e buxhetit e jo me 20 milion apo 2 milion, apo sa ishte ajo çështje e trafikut atje, prandaj nëse kalohet njëherë te një kategori, që nuk e kuptojnë këtu ose thjesht e ngatërrojnë mirëqenien publike me interesat e ngushta, ajo është çështje tjetër.

Kërkoj që dokumentacionin përkatës të tenderimit të na e dërgoni në adresën zyrtare. Meqë nuk e kemi pasur dokumentacionin përkatës, edhe në këtë propozimvendim e kundërshtojmë dhe nuk do ta votojmë.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, ngriti disa çështje, për të cilat tha se këto hapësira publike, të cilat Komuna i jep në shfrytëzim, është dashtë që të na jepen edhe të dhëna tjera shtesë se cilët janë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të Komunës, përshkrimin e pronës së paluajtshme, cila dhe ku është ajo pronë, sa është prona, në cilin vend, a është në harmoni me planet rregulluese urbane, a është në planin zhvillimor komunal, sa bilborda i ka, sa është numri i tyre etj .

Gjithashtu, vërejtje bëri edhe në afatin kohor që jepen në shfrytëzim këto prona. Është dashur të veprohet pak më ndryshe, pasi që 15 vjet janë shumë, pra edhe për këtë është dashur të na jepet një informatë.

Aktivitetin që do ta ushtrojnë shfrytëzuesit e këtyre pronave, Komisioni do të duhej ta kishte parasysh dhe të na japë një lloj sqarimi sa i përket kësaj se janë deleguar nga ky Kuvend.

Duke pasur parasysh këtë formë se si janë dhënë këto prona në shfrytëzim, GP i PDK-së këtë propozimvendim nuk do ta votoj për miratim.

Meliza Haradinaj, në emër të GP të AAK-së, tha se këtë propozimvendim plotësisht e përkrahim për miratim

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, e përkrahu propozimvendimin për miratim.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se meqë dalin disa gjëra këtu që nuk na kënaqin, që shkon në vend puna drejt, ne do të abstenojmë për këtë propozimvendim.

Me katër vota kundër dhe dy abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

Pikët e shtatë dhe e tetë

Lidhur me Propozimvendimi për bibliotekën komunale “Hivzi Sylejmani” dhe Propozimvendimin për teatrin e qytetit “Dodona” në Prishtinë, të pranishmit i njoftoi Agim Salihu.

Sadri Ramabaja tha se me që kemi të bëjmë me një akt juridik, të precizohet, sepse ky Vendim e bënë sikur të themelohet me këtë vendim. Atë për çka e bëri shpjegimin përkatës, të futet në tekstin e pikës së dytë ose pikë e veçantë. Ne votojmë për miratim.

Njëzëri u miratuan Vendimi për bibliotekën komunale “Hivzi Sylejmani” dhe Vendimi për teatrin e qytetit “Dodona” në Prishtinë.

Pika e nëntë

Lidhur me Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” SHA në Prishtinë, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Xhelil Bekteshi.

Aziz Pacolli tha se Komuna disa herë brenda vitit po i jep mjete ndërmarrjes “Pastrimi”, e cila është komunale, e faktikisht atje figuron se Komuna ka borxh ndaj ndërmarrjes “Pastrimi”. Do të ishte mirë që deri në mbledhjen e radhës këto gjëra të harmonizohen.

Shefki Gashi tha se nëse kjo vërtet qëndron, se Komuna i ka borxh kësaj kompanie, këto obligime duhet t’i kryej. Nuk ka nevojë as me i dhënë hua, as subvencione, ajo menaxhohet asisoj që krijon mjete të mjaftueshme për vetveten.

Rrahman Ismaili tha se GP e ka shqyrtuar këtë propozimvendimin për lejimin e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” dhe unanimisht është pajtuar që këto mjete t’i ndahen.

Naim Makoll bëri një sugjerim, duke thënë se gjithherë kur po japim subvencione për kompani publike të Komunës së Prishtinës, në fund nuk po e kemi një raport të atyre mjeteve financiare se a janë shfrytëzuar si duhet dhe në çfarë forme janë shfrytëzuar. Kisha propozuar që për të gjitha këto subvencione që po ua japim, kompanive publike të Komunës së Prishtinës, në një kohë të caktuar të na japin një llogaridhënie për shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

Njëzëri u miratua Vendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" SHA në Prishtinë.

**Pika e dhjetë dhe e njëmbëdhjetë
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme**

Shaip Hajrizi, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit:

Dua të paraqes një problem, i cili deri më tani mbetet i pazgjidhur. Fjala është për qentë endacakë, e që ndërkombëtarët nuk po e lejojnë vrasjen e tyre. Më parë kam pyetur se a ka mundësi që për këtë çështje të ndërtohet një strehimore, dhe Drejtorisë i kam pas ofruar tri projekte pa asnjë kompensim, që janë nga ndërkombëtarët. Një projekt i këtillë ka qenë para një jave në Komunën e Rahovecit, dhe unë mendoj se nëse punojmë me këto projekte me strehimore të qenve, të maceve etj., do të zgjidhet njëherë e përgjithmonë ky problem i Prishtinës.

Pyetje për Drejtorinë e Arsimit:

A ka paraparë Komuna e Prishtinës ndarjen e bursa për studentë?

Pyetje për Drejtorinë e Inspektionit:

A mund ta ushtrojnë veprimtarinë e vet internet-kafetë në afërsi të objekteve shkollore?

Një ë lokal i tillë është afër shkollës fillore "Asim Vokshi" ku, sipas informatave të drejtoreshës së shkollës, nxënësit ikin nga orët e mësimi dhe shkojnë në atë internet-kafe.

Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, tha se për vitin shkollorë 2013/14, kemi menduar t'i ndajmë diku rreth 50 bursa për nxënës dhe studentë të dalluar, të cilët duhet të jenë banorë të komunës së Prishtinës.

Mejreme Berisha, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Fshati Koliq ka mbetur pa transport dhe për mësues është vetëm një kombibus.

Pse të mos jetë edhe një linjë e transportit publik për Koliq ?

Pyetje për Drejtorinë e Arsimit:

Ndërtimi i sallës së edukatë fizike të shkollës së mesme "Xhevdet Doda" shihet se nuk është bërë sipas projektit. Sa i përket arkitekturës dhe

ndërtimtarisë, është e tmerrshme çfarë pune kanë bërë ata, por edhe nuk dihet kur mund të lëshohet në përdorim.

Çka do të bëhet me bibliotekën e kësaj shkolle dhe a do të ketë personel që do ta udhëheq atë bibliotekë?

Një shqetësim tjetër është edhe çështja e bufeve në afërsi të shkollave. Do të ishte mirë dhe shumë më e logjikshme të bëhet një bufe brenda shkollës sesa të bredhin fëmijët dhe të ikin. Shqetësim tjetër është edhe muzika me zë të lartë, e cila dëgjohej edhe në klasat e mësimi.

Lidhur me shqetësimet e shfaqura nga znj. Berisha, **Halim Halimi** dha sqarime të nevojshme.

Hetem Kupina, parashtrori këto pyetje:

Pyetjen e shtroi në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Komunitete.

Çfarë kanë bërë organet kompetente komunale për të miratuar ndonjë politikë të posaçme të ndonjë plani të veprimit, ndonjë dokument ose ndonjë rregullore, përmes së cilave do të adresoheshin nevojat e komunitetit RAE ?

Pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit:

Zotëri drejtor, cili është synimi juaj, gjegjësisht përkushtimi juaj që, në një të ardhme të afërt, t'i thoni ndal shkatërrimit të tokës bujqësore, ndërtimeve që po bëhen vend e pa vend në fshatrat: Bërnice, Bardhosh, Prugovc dhe Barilevë ?

Kërkesë e tij ishte që përgjigjet t'i kthehen me shkrim.

Shefqet Sylejmani, për Drejtorinë e Inspektionit:

Kërkojë që inspektioni të kryej punët në lagjen "Tophane", gjegjësisht në hapësirën para Gjykatës së Qarkut, lidhur me largimin e kamionëve, traktorëve dhe punëtorëve të krahut nga kjo lagje.

Njëherësh ai shtroi pyetjen lidhur me përkatësinë e pronës që gjendet prapa bibliotekës "Hivzi Sylejmani" në lagjen "Tophane".

Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit:

Kërkoj që të shpejtohet puna e Komisionit, që ta bëjë pranimin teknik, lejen e përdorimit dhe ndarjen e pronës në mes të Komunës dhe investitorit në kompleksin e banesave "Dielli" në lagjen "Kodra e Diellit", si dhe NPL "Hortikultura" ta rregullojë parkun në kompleksin banesor "Dielli".

Për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

Kërkoj nga kjo drejtori që të ndërtojë një terren sportiv në lagjen "Kodra e Trimave".

Kimet Zeqa, pyetje për Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe ai i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, a kanë njohuri për ndonjë marrëveshje, sepse mjekët privatë shkojnë për vizita sistematike si orale, ashtu edhe shëndetësore, të gjitha të kompletuara, nëpër çerdhe dhe shkolla?

Pse nuk futet në funksion Ambulanca shëndetësore e studentëve?

Këtë çështje e kam potencuar edhe më parë. Nga kjo shihet se menaxhimi i mjekësisë familjare nuk po funksionon mirë dhe nuk ka transparencë të duhur për mjekësinë familjare.

Do të ishte mirë që të punohet në këtë drejtim dhe të shihet mundësia që secilit student që paraqitet të pranohet në konvikt, do duhej t'i paraqitej kusht për pranim edhe certifikata e mjekut.

Po të funksiononte Komiteti për shëndetësi, shumë çështje do t'i kisha paraqitur në komitet dhe me ato propozime, në bashkëpunim me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, do t'i kishim adresuar për Kuvend.

Ajnishahe Azemi propozoi që me rastin e 7 marsit, Ditës së Mësuesit, të gjendet ndonjë formë e shpërblimit për mësime të ndryshme të gjitha niveleve në komunën e Prishtinës,

çoftë me blerjen e ndonjë dhurate apo me ndonjë organizim tjetër.

Pyetja tjetër është se a ka mundësi që të gjitha femrat që punojnë në Komunën e Prishtinës, të shpërblehen në ndonjë formë me rastin e festës 8 Marsi.

Lidhur me propozimin e dhënë nga znj. Azemi, **Halim Halimi** dha sqarim të nevojshme.

Mbledhja mbaroi në orën 13:50

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc. i dipl.